



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT BUJQËSOR

Nr. 4391 Prot.

Patos, më 12.12.2024

MIRATOI
KRYETARI
Fation Duro



PROJEKTVENDIM

Nr. 91, datë 12.12.2024

PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË ZHVILLIMIT BUJQËSOR 2025-2027

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 111, datë 07.02.2019 "Për kadastrën", i ndryshuar, ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural" si dhe VKM-së nr. 460, datë 29.6.2022 "Për miratimin e strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021–2027", grupi i punës hartoi Planin Lokal të Zhvillimit Bujqësor 2025-2027 dhe i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e Planit Lokal të Zhvillimit Bujqësor 2025-2027 sipas shtojcës 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.

Grupi i punës

Orges Golloshi

Lindita Pepa

Blerina Laçi

Marjus Shabanaj

Valbona Semanjaku

Juriste

Nurkë Hazizaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT BUJQËSOR

Nr. 4381/Prot.

Patos, më 12.12.2024

RELACION

“PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË ZHVILLIMIT BUJQËSOR 2025-2027”
KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ku përcaktohen funksionet e bashkisë në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, ligjin nr. 9817/2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” si dhe VKM-në nr. 460, datë 29.6.2022 “Për miratimin e strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit 2021–2027”, kemi hartuar Planin Lokal të Zhvillimit Bujqësor 2025-2027, i cili kaloi dhe në konsultim publik me grupet e interesit në datën 11.12.2024.

Në këtë plan kemi bërë një përshkrim të përgjithshëm të aktiviteteve bujqësore si dhe pasqyrim të situatës aktuale të sistemit ujitës dhe kullues. Gjithashtu kemi bërë një analizë të problematikave si dhe kemi përcaktuar objektiva për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor. Objektivat e planit përfshijnë një dimension të gjerë politikash për zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor si:

- Qartësimin e së drejtës së pronës;
- Investime në infrastrukturë;
- Mbështetje financiare të drejtpërdrejta ose jo;
- Mbështetje për zhvillimin lokal gjithëpërfshirës;
- Forcimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe ndërmarrja e veprimeve për klimën;
- Sigurimi i të ardhurave të qëndrueshme për fermerët dhe rezistenca ndaj presioni të tregut.

Për arritjen e qëllimit kryesor të këtij plani, i cili është të promovojë një sektor bujqësor të qëndrueshëm, produktiv dhe konkurrues, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e Planit Lokal të Zhvillimit Bujqësor 2025-2027 sipas shtojcës 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij projektvendimi.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Bujqësor.

Grupi i punës

Orges Gollosi

Lindita Pepa

Blerina Laçi

Valbona Semanjaku

Marjus Shabanaj

KRYETARI
Fation Duro



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT BUJQËSOR



MIRATOI
KRYETARI
Faton Duro

PLANI LOKAL I ZHVILLIMIT BUJQËSOR 2025-2027

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|---|----|
| Qëllimi | 3 |
| Baza ligjore | 3 |
| 1. Përshkrimi i përgjithshëm i bashkisë Patos | 4 |
| 2. Bujqësia në bashkinë Patos | 5 |
| 2.1 Bujqësia dhe ndarja e tokës | 5 |
| 2.2 Aktivitetet bujqësore në bashkinë Patos | 5 |
| 2.2.1 Aktivitetet bujqësore në kultivimin e bimëve të arave | 6 |
| 2.2.2 Aktivitetet bujqësore në kultivimin e perimeve në serra | 7 |
| 2.2.3 Aktivitetet bujqësore në kultivimin e drufrutorëve | 7 |
| 2.3 Aktivitete blegtorale | 8 |
| 2.4 Sistemi ujitës dhe kullues në bashkinë Patos | 10 |
| 3. Agropërpunimi | 12 |
| 4. Subvencionet në bujqësi | 12 |
| 5. Analiza e problematikave | 14 |
| 6. Objektivat për zhvillimin bujqësor | 15 |
| Anekse | 22 |

QËLLIMI

Qëllimi kryesor i planit është të promovojë një sektor bujqësor të qëndrueshëm, produktiv dhe konkurrues dhe ka për qëllim të mbështesë rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike dhe përmirësojë jetesën e fermerëve dhe komuniteteve rurale. Ky dokument synon të evidentoj ndërhyrjet që duhen ndërmarrë në lidhje me aspekte institucionale, teknike dhe financiare, burimet njerëzore dhe evidentimin e fermerëve të shërbyer për zhvillimin bujqësor në Bashkinë Patos. Gjithashtu dokumenti do të pasqyrojë se kur duhet të ndërmerret aktiviteti dhe cili është institucioni përgjegjës për ta realizuar atë.

BAZA LIGJORE

Për hartimin e strategjisë së zhvillimit Bujqësor jemi mbështetur në:

1. VKM Nr. 460, datë 29.6.2022 “Për miratimin e strategjisë së bujqësisë, zhvillimit rural dhe peshkimit, 2021–2027”
2. Ligji nr. 9817/2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”;
3. Ligji nr. 9863 datë 28.1.2008, “Për ushqimin”;
4. Ligji nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”;
5. Ligji nr. 17/2020, “Për produktet plehëruese”;
6. Ligji nr. 103/2016, “Për akuakulturën”;
7. Ligji nr. 8752/2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”;
8. Ligji nr. 8312/1998, “Për tokat bujqësore të pandara”;
9. Ligji nr. 9244/2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”;
10. VKM Nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”;
11. Ligji nr. 24/2017, “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit”;
12. Ligji nr. 38/2012, “Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor”;
13. Ligji nr. 162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit dhe mjedisit”;
14. Ligji nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”;
15. Ligji nr. 36/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”.
16. Ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën”;
17. Ligji nr.20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”;
18. VKM nr. 59, datë 28.1.2005 “Për kryerjen e analizave të vlerave të treguesve të tokës bujqësore”;
19. Ligji nr. 36/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit”.

1. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM I BASHKISË PATOS


Bashkia Patos është pjesë e qarkut të Fierit ndodhet 7 km në jugperëndim të qytetit të Fierit, shtrihet përgjatë vargut kodrinor i cili ndan fushën e Myzeqesë nga lugina e lumit Gjanica dhe kufizohet me bashkinë Patos, me bashkinë Fier dhe bashkinë Mallakastër me një sipërfaqe prej 82.5 km², ku pika më e lartë arrin në fshatin Drenie 498 m mbi nivelin e detit dhe me shtrirje minimale në fushat e fshatit Sheqishte 11.2 m.

Bashkia ka një pozitë gjeografike të favorshme duke qenë në afërsi të rrugës nacionale Fier-Berat, Tiranë-Vlorë.

Bashkia Patos është pjesë përbërëse e qarkut të Fierit. Bashkia administron qytetin e Patosit dhe gjithsej 18 fshatra me këtë nën-ndarje administrative:

- **Njësia Administrative Patos** përfshin fshatrat Kuqar, Dukas, Rerës, Margëlliç, Rusinjë, Banaj, Grizë-Lënginas.
- **Njësia Administrative Zharrëz** përfshin fshatrat Zharrëz, Fshat i Ri, Verbas, Frashër, Sheqishte, Belinë.
- **Njësia Administrative Ruzhdie** përfshin fshatrat Ruzhdie, Siqecë, Gjinoqarë, Drenie, Kasnicë.

Sipas regjistrit të INSTAT (CENSUS) në vitin 2011 numri i popullsisë, në bashkinë Patos është 22,959 banorë, ndërsa sipas regjistrit të Gjëndjes Civile, bashkia ka një popullsi prej 42,889 banorësh dhe një densitet prej 278.3 banorë / km².



2. BUJQËSIA NË BASHKINË PATOS

Bujqësia në bashkinë Patos është një sektor i rëndësishëm. Kushtet klimaterike të bashkisë Patos janë të favorshme për zhvillimin e shumë kulturave bujqësore si fruta-perimet, drithërat, ullishtet, vreshtat etj. Karakteristikat optimale gjeografike dhe klimatike mundësojnë kushte të favorshme për kultivimin e një numri të madh kulturash bujqësore, duke i shfrytëzuar tokat më shumë se një herë në vit për mbjellje të ndryshme. Pavarisht zhvillimit të industrisë së nxjerrjes së naftës në zonë, në territorin e Bashkisë Patos, bujqësia është sektori me rëndësinë më të madhe ekonomike përsa i përket punësimit dhe të ardhurave për familjet. Në sektorin bujqësor janë të punësuar më shumë se 1/3 e popullsisë së Bashkisë Patos. Me ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore (ligj 115/2014), zona e Bashkisë së re ka sipërfaqe toke bujqësore të barabartë me 6,054 ha, nga të cilat 3,254 janë tokë bujqësore në fushë dhe 2,800 ha shtrihen në kodra të ulta. Përpos këtyre, në territorin e Bashkisë Patos, janë edhe 752 ha pyll dhe dy ujëmbledhës në funksion të ujitjes.

2.1 Bujqësia dhe ndarja e tokës

Me ndarjen administrativo-territoriale të vitit 2014, bashkisë Patos i'u shtua njësia administrative Zharrëz dhe njësia administrative Ruzhdie. Në të treja njësitë fondi i tokës bujqësore për t'u ndarë me ligjin nr. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", i ndryshuar (*tashmë shfuqizuar me ligjin Nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"*), ka qenë 6054 ha. Të dhënat për fondin e tokës dhe sipërfaqen e ndarë janë sipas tabelës së mëposhtme:

| Njësia Administrative | Fondi i tokës bujqësore (Ha) | Nga kjo: | | Shënime |
|-----------------------|------------------------------|---------------|-----------|------------------------------|
| | | E ndarë | E pandarë | |
| Zharrëz | 2257 | 2100 | | 157 Ha e zënë me puse nafte |
| Ruzhdie | 1363 | 1011 | 352 | |
| Patos | 2434 | 2393.4 | | 40.6 dhënë me qera nga MBZHR |
| TOTAL | 6054 | 5504.4 | | |

2.2 Aktivitetet bujqësore në bashkinë Patos

Numri i familjeve bujqësore që kanë përfituar tokë bujqësore është 3803, përkatësisht 1400 familje në Njësinë Zharrëz, 673 familje në Njësinë Ruzhdie si dhe 1730 familje në Njësinë Patos. Pjesa më e madhe janë pajisur me NIPT fermeri dhe kanë qenë përfitues të skemave kombëtare në bujqësi (AZHBR dhe IPARD).

2.2.1 Aktivitetet bujqësore në kultivimin e bimëve të arave

Qarku i Fierit është potenciali më i madh në shkallë kombëtare në kultivimin e bimëve të arave. Në këtë qark kultivohen një masë e lartë e bimëve të arave, kryesisht gruri, misri, elb, tagjira dhe grupi i foragjerëve.

Referuar të dhënave për vitin 2023, të marra nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Lushnje (AREB) për prodhimin e bimëve të arave, gruri, misri dhe foragjerët zënë sipërfaqen më të madhe të kultivuar.

| Nr | Emërtimi | Sipërfaqe Ha | Rend Kv/Ha | Prodhimi në Ton | |
|-----------|--------------------------------------|--------------|--------------|-----------------|------------------------|
| | | | | Kulturë e I | I+II+Bashkë shoqëruese |
| A | Drithra buke gjith kult. I-rë | 1000 | 42.6 | 4255 | 4775 |
| | 1. Grurë | 470 | 35 | 1645 | 1645 |
| | 2. Misër | 380 | 57.1 | 2170 | 2690 |
| | 3. Thekër | | | | |
| | 4. Elb | 50 | 38 | 190 | 190 |
| | 5. Tagjira | 100 | 25 | 250 | 250 |
| B | Perime gjithsej | 344 | 310.9 | 10695 | 14228 |
| I | Perime fushe | 313 | 257.7 | 8065 | 9598 |
| | 1. Perime te njoma | 184 | 194.3 | 3575 | 5108 |
| | 2. Perime te thata | 39 | 100 | 390 | 390 |
| | 3. Bostane | 90 | 455.6 | 4100 | 4100 |
| II | Serra | 31 | 848.4 | 2630 | 4630 |
| C | Patate | 80 | 200 | 160 | 160 |
| | Nga kjo: Patate e parë | | | | |
| | Nga kjo: Patate e dytë | | | | |
| D | Fasule direkte | 105 | 14.3 | 15 | 15 |
| | Nga kjo: Pllaqi | | | | |
| | Fasule bashkshoqëruese | | | | |
| E | Kultura industriale gjithsej | | | | |
| | 1. Duhan | | | | |
| | 2. Luledielli | | | | |
| | 3. Panxharsheqeri | | | | |
| | 4. Sojë | | | | |
| F | Bimë Medicinale | | | | |
| | Lule Ciami | | | | |
| | Sherebel | | | | |
| | Rigon | | | | |

| | | | | | |
|----------|-------------------------------------|-------------|--------------|-------------|-------------|
| | Te tjera | | | | |
| G | Luleshtrydhe | 1 | 400 | 40 | 40 |
| H | Foragjere të njoma | 1065 | 311.3 | 3315 | 3780 |
| | Jonxhë gjithsej | 885 | 330.5 | 29250 | 29250 |
| | Nga kjo: Jonxhë e re | 190 | 200 | 3800 | 3800 |
| | Misër foragjer | 80 | 262.5 | 2100 | 2100 |
| | Hasëll | | | | |
| | Të tjera | 100 | 180 | 1800 | 4050 |
| | Foragjere nga toka djerr, kullota | | | | |
| | Sipërfaqe gjithsej e mbjellë | 2595 | | | |

2.2.2 Aktivitetet bujqësore në kultivimin e perimeve në sera

Referuar tabelës së mësipërme, sipas të dhënave të marra nga AREB për vitin 2023, në territorin e bashkisë Patos ka rreth 31 Ha sera, që në total kanë pasur një prodhim prej 4630 ton. Pavarësisht raportimit të AREB, Dega Fier, nga ana jonë është bërë një verifikim i sipërfaqes totale të serave dhe rezultojnë 43 ha që i posedojnë 162 fermerë.

2.2.3 Aktivitetet bujqësore në kultivimin e drufrutorëve

Prodhimi i drufrutorëve përfaqësohet nga prodhimi i pemëve frutore, ullinjve, agrumeve dhe rrushit. Referuar statistikave të bujqësisë për vitin 2023 të publikuar nga INSTAT, qarku i Fierit zë vendin e tretë në prodhimin e pemëve frutore. Prodhimi i pemëve frutore për vitin 2023 në bashkinë Patos është sipas tabelës së mëposhtme (të dhënat e marra nga AREB):

| Nr | Emërtimi | Rrënjë Gjithsej | Sipërfaqja gjithsej (Ha) | Rendimenti kg/rr, kv/ha | Prodhimi (Ton) |
|----------|---------------------|-----------------|--------------------------|-------------------------|----------------|
| I | Pemë frutore | 104355 | 91 | 18.92 | 1611.5 |
| 1 | Mollë | 11660 | 10.7 | 20.66 | 218 |
| 2 | Dardhë | 11540 | 7.5 | 21.11 | 190 |
| 3 | Ftonj | 8590 | 0 | 25.14 | 186 |
| 4 | Kumbulla | 5355 | 1 | 22.21 | 95.5 |
| 5 | Qershi | 3800 | 18.5 | 25.53 | 97 |
| 6 | Pjeshkë | 2820 | 2.5 | 22.18 | 55 |
| 7 | Kajsi | 1350 | 2.5 | 22.96 | 31 |
| 8 | Fig | 1610 | 2.5 | 21.28 | 30 |
| 9 | Hurma | 5680 | 0 | 25.74 | 105 |
| 10 | Shegë | 7460 | 2.5 | 27.45 | 182 |
| 11 | Mana | 14530 | 2.5 | 28.21 | 323 |
| 12 | Gështenja | 120 | 0 | 13.33 | 1.6 |
| 13 | Arra | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | |
|------------|------------------------|---------------|---------------|--------------|--------------|
| 14 | Bajame | 5240 | 9.5 | 14.64 | 50.5 |
| 15 | Lajthi | 2740 | 0 | 15 | 30 |
| 16 | Të tjera | 22010 | 33.8 | 4.6 | 28 |
| II | Ullinj gjithsej | 223830 | 2148.5 | 10.43 | 2124 |
| | Nga këta: Për tavolinë | 70780 | 1110 | 10.17 | 660 |
| III | Agrume gjithsej | 24830 | 0 | 18.88 | 362.5 |
| 1 | Portokalle | 10195 | 0 | 19.41 | 165 |
| 2 | Limon | 5012 | 0 | 16.32 | 55.5 |
| 3 | Mandarina | 9623 | 0 | 19.45 | 142 |
| 4 | Të tjera | 0 | 0 | 0 | 0 |
| IV | Rrush gjithsej | x | x | x | 1040 |
| 1 | Vreshti | | 69 | 92.03 | 635 |
| 2 | Pjergulla | 96100 | x | 4.76 | 405 |

2.2 Aktivitetet blegtorale

Blegtoria është një nga degët kryesore të bujqësisë, që merret me rritjen, mbarështimin dhe përmirësimin e rracave të bagëtive për të marrë prej tyre produktet më jetike për njeriun, qumështin dhe mishin si lëndë të para. Bashkia e Patosit, në territorin e saj ka edhe një numër të lartë burimesh blegtorale ku përfshihen kafshë të shumëllojshme. Blegtoria është një nga degët më të rëndësishme e prodhimit ekonomik të fermave rurale private në territorin e Bashkisë Patos. Gjithashtu, bletaria është një sektor me shumë të ardhme dhe që po rritet ndjeshëm pothuaj në gjithë territorin. Referuar të dhënave të marra nga Drejtoria Rajonale e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve Vlorë, shumëllojshmëria blegtorale është sipas tabelës së mëposhtme:

| Nj. Adm. | Nr. ferma | Të leshta | Të dhirta | Gjedhë | Derra | Njëthundrakë | Shpendë | Bletë |
|--------------|-------------|-------------|------------|------------|-------------|--------------|--------------|-------------|
| Patos | 773 | 1278 | 120 | 137 | 2 | 18 | 12504 | 2390 |
| Zharrëz | 1454 | 1561 | 144 | 578 | 1412 | 90 | 25131 | 589 |
| Ruzhdie | 455 | 240 | 94 | 48 | 0 | 107 | 6653 | 653 |
| TOTAL | 2682 | 3079 | 312 | 763 | 1414 | 215 | 44288 | 3632 |

Në territorin e bashkisë Patos ushtrojnë veprimtari blegtorale disa subjekte sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Njësi Blegtorale | NIPT-i | Fshati/ Nj.Administrative | Objekti i veprimtarisë |
|-----|------------------|--------|------------------------------|------------------------|
| | | | | |

| | | | | |
|---|---------------------|------------|-----------------------|---|
| 1 | FERMA A & E 2018 | L83605402Q | Sheqishte/ Zharrëz | Mbarështimi i kafshëve në fermat agrolektorale të mëdha. Tregtia me shumicë e kafshëve të gjalla |
| 2 | ÇUKAJ FARM | M02612405U | Gjinoqar/ Ruzhdie | Mbarështimi blegtoral të imta dhe të trasha, mbarësim dhe prodhim bletësh. Prodhim, shitje, import-eksport të prodhimeve blegtoriale si mish, bulmet, mjaltë, etj. |
| 3 | Mikail Prifti | K93608402I | Frashër/ Zharrëz | Mbarështimi i kafshëve në fermat agrolektorale të mëdha. |
| 4 | DRIZA shpk | | Verbas/ Zharrëz | |

Gjithashtu referuar aplikimeve të bëra në skemën mbështetëse të AZHBR-së për vitin 2024, ushtrohet aktiviteti në mbarësim e gjedhëve, të imtave dhe bletëve nga blegtorët sipas tabelës së mëposhtme:

| Nr. | Blegtori | Fshati/ Nj. Administrative | Njësia blegtorale | Sasia |
|-----|-------------------|-------------------------------|----------------------|-------|
| 1 | Petraç Silo | Frashër/ Zharrëz | Lopë | 25 |
| 2 | Landi Thimjo | Zharrëz/ Zharrëz | Lopë | 10 |
| 3 | Pandeli Rama | Frashër/ Zharrëz | Lopë | 11 |
| 4 | Lami Baço | Sheqishte/ Zharrëz | Lopë | 13 |
| 5 | Elisabeta Kocaqi | Sheqishte/Zharrëz | Lopë | 10 |
| 6 | Erlind Grembi | Belinë/Zharrëz | Lopë | 11 |
| 7 | Tomorr Metaj | Patos | Lopë | 10 |
| 8 | Armand Sanxhaku | Patos | Dele | 400 |
| 9 | Albiont Sanxhaku | Patos | Dele | 400 |
| 10 | Landi Thimjo | Zharrëz/ Zharrëz | Dele | 140 |
| 11 | Pandeli Naka | Zharrëz/ Zharrëz | Dele | 150 |
| 12 | Ardian Xhafa | Sheqishte/ Zharrëz | Dele | 170 |
| 13 | Klarida Semanjaku | Sheqishte/ Zharrëz | Dele | 120 |
| 14 | Kimet Gremi | Belinë/ Zharrëz | Dele | 120 |
| 15 | Juriglen Shabani | Frashër/ Zharrëz | Dele | 110 |
| 16 | Bledar Grembi | Sheqishte/ Zharrëz | Dele | 110 |
| 17 | Festim Hoxha | Verbas, Zharrez | Dele | 110 |
| 18 | Juriglen Shabani | Frashër/ Zharrëz | Dhi | 20 |
| 19 | Armand Sanxhaku | Patos | Koshere | 110 |

| | | | | |
|----|-------------------|------------------|---------|-----|
| 20 | Kreshnik Muskaj | Patos | Koshere | 80 |
| 21 | Shpresa Kazazaj | Patos | Koshere | 139 |
| 22 | Gazmend Bashaj | Verbas/Zharrëz | Koshere | 100 |
| 23 | Ridvan Mullaj | Patos | Koshere | 120 |
| 24 | Nikolla Mitrusi | Dukas, Patos | Koshere | 60 |
| 25 | Arvis Velmishi | Dukas, Patos | Koshere | 52 |
| 26 | Ndriçim Kuka | Rrerës, Patos | Koshere | 65 |
| 27 | Mirela Gllava | Gjinoqarë, Patos | Koshere | 150 |
| 28 | Nefail Bregu | Margëlliç, Patos | Koshere | 150 |
| 29 | Viktor Mesutaj | Siqecë, ruzhdie | Koshere | 80 |
| 30 | Bukuroshe Beharaj | Patos | Koshere | 148 |
| 31 | Mikail Silo | Frashër/ Zharrëz | Koshere | 60 |
| 32 | Myfarete Kuka | Rrerës, Patos | Koshere | 150 |
| 33 | Vjollca Goga | Patos | Koshere | 150 |
| 34 | Enver Allkushi | Patos | Koshere | 145 |
| 35 | Jonida Gribizi | Frashër/Zharrëz | Koshere | 176 |
| 36 | Shefit Çausaj | Siqecë/Ruzhdie | Koshere | 58 |
| 37 | Agim Velmishi | Dukas, Patos | Koshere | 100 |
| 38 | Dashnor Bengaj | Siqecë, Ruzhdie | Koshere | 160 |
| 39 | Shefqet Çausaj | Siqecë/Ruzhdie | Koshere | 150 |
| 40 | Ferrik Grembi | Belinë | Koshere | 75 |
| 41 | Melo Alushaj | Dukas, Patos | Koshere | 60 |
| 42 | Hyqmet Hazizaj | Patos | Koshere | 80 |
| 43 | Isa Baha | Zharrëz/ Zharrëz | Koshere | 100 |

Madhësia minimale e një ferme ekonomkisht të qëndrueshme në blegtori, sipas numrit të krerëve, është si më poshtë: 10 lopë qumështi, 130 të imëta (dele/dhi), 15 viça për mish (15 krerë për një cikël x 2 cikle në vit), 20 dosa ose 20,000 zogj pule për mish për një cikël (5 cikle në vit).

2.3 Sistemi ujitës dhe kullues në bashkinë Patos

Sistemi ujitës dhe kullues është transferuar në pronësi të bashkisë Patos me VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”, i ndryshuar me VKM-në nr. 847, datë 28.10.2020.

Sistemi i kullimit në pronësi të bashkisë përfshin kanalet e II-të dhe të III-të kullues me një gjatësi totale prej 164 km.

Sistemi ujitës i transferuar përfshin rezervuarin e Zharrëzës (skema FRU-36) me 28 km kanale, elektro-pompën e Belinës (FRU-30) dhe një sistem kanalesh prej 126 km pjesë e skemës FRU-3-1, e cila burim ujqor ka rezervuarin e Kurjanit.

Deri në 6-mujorin e parë të vitit 2024 është ndërhyrë në pastrimin e 66 % të sistemit kullues total dhe vazhdon mirëmbajtja e tyre. Në sistemin ujitës është ndërhyrë më pak për shkak se fokusi ka qenë në mbrojtjen nga përmbytja si dhe për shkak të mungesës së burimeve ujore për furnizimin me ujë të skemave.



Harta e sistemit (DUK Fier)

Prioritet konsiderohet rritja e aftësive ujitëse në territorin e Bashkisë në funksion të zhvillimit të bujqësisë. Bazuar në verifikimet e bëra në terren dhe aftësisë ujitëse të burimeve ujore, vetëm 900 Ha mund të ujqiten nga të treja skemat ujitëse (FRU-3-1, FRU-36, FRU-30) pavarësisht se sipërfaqja e projektuar nën ujë është 2475 Ha.

Niveli i ulët i aksesit në ujqitje ndikon në rendimentin dhe cilësinë e produkteve bujqësore dhe rrjedhimisht në të ardhurat e fermerëve.

3. AGROPËRPUNIMI

Në territorin administrativ të bashkisë Patos operojnë disa njësi agropërpunime, kryesisht fabrika të vajit të ullirit, të përpunimit të mishit, një njësi për përpunimin e qumështit si dhe një kantinë vere. Për sektorin e fruta-perimeve edhe pse është shumë i rëndësishëm nuk ka asnjë pikë grumbullimi në territorin e bashkisë. Në tabelën e mëposhtme jepen njësitë agropërpunuese që ndodhen në territorin e bashkisë Patos.

| Nr. | Njësia Agropërpunuese | Njësia Administrative | Fshati | Aktiviteti |
|-----|----------------------------|-----------------------|-------------------|-------------------|
| 1 | Ferma Semanjaku | Zharrëz | Sheqishte | Përpunim mishi |
| 2 | Fresh Chicken Albania 2019 | Patos | Lagjja “29 Marsi” | Përpunim mishi |
| 3 | 2A Manxhari | Ruzhdie | Gjinoqarë | Fabrikë vaji |
| 4 | “Lamaj” Shpk | Patos | Dukas | Fabrikë vaji |
| 5 | “Shpata 2003” shpk | Patos | Dukas | Fabrikë vaji |
| 6 | Gllava | Ruzhdie | Gjinoqarë | Fabrikë vaji |
| 7 | Myrtaj | Ruzhdie | Ruzhdie | Fabrikë vaji |
| 8 | Bengaj | Ruzhdie | Drenie | Fabrikë vaji |
| 9 | Rizaj | Patos | Lagjja “29 Marsi” | Fabrikë vaji |
| 10 | Kantina “Arianiti” | Patos | Lagjja “29 Marsi” | Kantinë vere |
| 11 | Përparim Braçe | Zharrëz | Zharrëz | Përpunim qumështi |

4. SUBVENCIONET NË BUJQËSI

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me VKM-në nr. Nr. 130, datë 06.03.2024 dhe VKM-në Nr. 581, datë 18.09.2024 ka përcaktuar kriteret bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë e zhvillimin rural, për vitin 2024. Masat që mbështeten drejtpërdrejtë dhe mbështetje financiare në investime janë si më poshtë:

| Nr. i masës | Emërtimi i masës mbështetëse |
|-------------|--|
| 1 | Pagesa në vlerën deri në 10 000 (dhjetë mijë) lekë/krerë lopë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 10 (dhjetë) krerë. Për pjesën mbi 50 (pesëdhjetë) krerë, masa e përfitimit |

| | |
|---|---|
| | zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “Shoqëri të Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB)” |
| 2 | Pagesa në vlerën deri në 1 200 (njëmijë e dyqind) lekë/krerë për tufën bazë të matrikulluar (kafshët riprodhuese), për fermer/aplikant me jo më pak se 100 (njëqind) krerë dele dhe/ose dhi. Për pjesën mbi 300 (treqind) krerë masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”. |
| 3 | Mbarështim i bletarisë në vlerën deri në 1 000 (një mijë) lekë për zgjua, për fermer/aplikant me jo më pak se 50 (pesëdhjetë) zgjoje. Për pjesën mbi 150 (njëqind e pesëdhjetë) zgjoje, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”. |
| 4 | Pagesa në vlerën deri në 200 000 (dyqind mijë) lekë për ha për sezon dhe jo për më shumë se 2 sezona, për kultivimin e perimeve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermer/aplikant me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha. Për sipërfaqen mbi 5 (pesë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB” |
| 5 | Pagesë për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike në vlerën deri në 30 000 (tridhjetë mijë) lekë/ha, për fermer/aplikant me sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 (një) ha. Për sipërfaqen mbi 10 (dhjetë) ha, masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB” |
| 6 | Fermat organike për periudhën në kalim, vitin e parë, në vlerën 100 000 (njëqind mijë) lekë, në vitin e dytë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, vitin e tretë 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë për fermë të certifikuar. |
| 7 | Implementimi dhe certifikimi global GAP, përfshirë mbulimin e kostove të analizave të produkteve, në perime, fruta, rrush, ullinj, agrume dhe kultura të tjera bujqësore të certifikueshme, në masën 50 (pesëdhjetë) % të vlerës totale të faturës tatimore: i. por jo më shumë se 175 000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha për certifikim individual; ii. por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 3 (tre) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 10 (dhjetë) ha në fushë të hapur, për certifikim në grup me minimum 10 (dhjetë) fermerë të përfshirë; iii. por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, për sipërfaqe jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) ha në ambiente të mbrojtura dhe jo më pak se 30 (tridhjetë) |
| 8 | Mbështetje për naftën për punimet e mekanizuara në bujqësi. |
| 9 | Për ndërtimin e serrave diellore të reja me sipërfaqe jo më pak se 0.2 ha (zero presje dy) dhe jo më shumë se 2 (dy) ha për subjekt, përfshirë edhe instalimin e sistemit të ujitjes. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se: -1 5,000,000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë/ha për serrat e prodhimit të perimeve; - 8,000,000 (tetë milionë) lekë/ha për serrat |

| | |
|----|---|
| | e prodhimit të rrushit për tavolinë; - 4,000,000 (katër milionë) lekë/ha për serrat (tunelet plastike) të prodhimit të luleshtrydheve. |
| 10 | Rrjeta për mbrojtjen e prodhimit nga breshëri në blloqet ekzistuese me pemë frutore, agrume dhe vreshta. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë/ha. Financimi të bëhet për sipërfaqe jo më pak se 1 (një) ha dhe jo më shumë se 5 (pesë) ha; |
| 11 | Për ndërtimin e ambienteve për mbarështimin e kafshëve dhe stabilimenteve për rritjen e shpendëve, me kapacitet jo më pak se 10 (dhjetë) lopë, jo më pak se 100 (njëqind) të imta, jo më pak se 10 (dhjetë) dosa dhe jo më pak se 10,000 (dhjetë mijë) shpendë. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 15,000,000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë për subjekt; |
| 12 | Për blerjen e traktorëve, makinerive dhe pajisjeve për mekanizimin dhe modernizimin e proceseve të punës në fermat bujqësore dhe blegtorale. Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 5,000,000 (pesë milionë) lekë për subjekt; |
| 13 | Mbështetje për akuakulturën detare për koshat e rritjes së peshkut (vetëm për koshat dhe rrjetat). Masa e përfitimit të jetë në 50% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 20,000,000 (njëzet milionë) lekë për subjekt.” |

Gjithashtu dhe vetë bashkia në programin e Bujqësisë ka parashikuar një fond të caktuar për mbështetjen e fermerëve. Në vitin 2022 janë mbështetur gratë fermere ndërsa në vitin 2023 fermerët e rinj. Në çdo moment për vendosjen e kriterëve për të përfituar nga ky fond është mbajtur parasysh barazia gjinore, moshja dhe vendndodhja territoriale e aplikuesve.

5. ANALIZA E PROBLEMATIKAVE

Disa nga problematikat që hasen për zhvillimin bujqësor dhe blegtoral në bashkinë Patos janë:

1. Mungesa e azhornimit në disa fshatra dhe problematika e regjistrimit fillestar në disa zona kadastrale ka sjell pengesë për fermerët për pajisjen me certifikatë pronësie duke i përjashtuar nga mundësia e përfitimit të investimeve në bujqësi. Çështjet e pronësisë së tokës (kryesisht të lidhura regjistrimin e titujve të pronësisë dhe pajisjen me certifikatë pronësie) njihen si një pengesë e rëndësishme në procesin e konsolidimit të fermave, që ndikon në arritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të tyre.
2. Kapacitete të pamjaftueshme për vaditje, mungesa e burimeve ujore për të siguruar ujitjen e kulturave bujqësore. Tendencat e ndryshimeve klimatike të parashikuara për Shqipërinë, tregojnë rritje të temperaturës mujore prej 1–2°C gjatë verës, ndryshueshmëri të reshjeve dhe shtim të ngjarjeve ekstreme të motit, duke përbërë një tjetër sfidë për prodhimin bujqësor, furnizimin me ujë, sigurimin e ushqimit dhe rritjen ekonomike për shumicën e popullsisë rurale.

3. Mungesa e kullimit në disa parcela, kanalet kullues të së cilave nuk janë pastruar për shkak të mbushjes së tyre me mbetje hidrokarbure nga aktiviteti ndër vite i industrisë naftënxjerrëse;
4. Mungesë ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimi me fermerët për mbajtjen në gatishmëri të rrjetit tercial dhe mos grumbullimin e mbetjeve bujqësore në bankinat e sistemit ujitës dhe kullues;
5. Fermat janë të vogla dhe të parcelizuara. Madhësia e kombinuar me fragmentimin dhe të drejtën e paqartë të pronës janë sfidat kryesore për rritjen dhe konkurrencën e sektorit të bujqësisë. Pronarët e vegjël luajnë rol të rëndësishëm për sigurimin e ushqimit të popullsisë shqiptare, si dhe për uljen e varfërisë në zonat rurale, por janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në zinxhirët e shkurtër të furnizimit. Vështirësitë strukturore të trashëguara të fermave, po mbështeten nga politika publike, të cilat synojnë bashkimin e fermerëve në procesin e tregtimit të produkteve bujqësore.
6. Fondet e alokuara për ujitjen dhe kullimin janë të pamjaftueshme për ndërtimin e skemave që do të mbulojnë një sasi të konsiderueshme të tokave bujqësore;
7. Mungesë të dhënash për cilësinë e tokës bujqësore (boniteti) duke ndikuar drejtpërdrejtë në cilësinë e prodhimit bujqësor;
8. Mungesa e pikave të grumbullimit dhe ruajtjes së produkteve bujqësore;
9. Gjendja jo e mirë e disa rrugëve bujqësore;
10. Mungesa e një tregu lokal për të rritur konkurueshmërinë dhe çmimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.

6. OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT BUJQËSOR

Për përmirësimin e gjendjes aktuale dhe zhvillimin bujqësor do të përcaktohen disa objektiva për periudhën 2025-2027, të cilat do të rishikohen sa herë ka ndryshime në legjislacion ose situatën faktike.

Objektivat për zhvillimin bujqësor në bashkinë Patos do të mbështeten në objektivat e politikave të zhvillimit bujqësor dhe rural bazuar në ligjin nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural” synojnë:

1. Në rritjen e të ardhurave për popullsinë rurale, duke rritur mirëqenien e saj, nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës dhe të jetesës, si dhe duke krijuar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë;
2. Në rritjen e prodhimit nëpërmjet nxitjes së konkurrueshmërisë dhe të progresit teknik, si dhe garantimit të një përdorimi optimal të faktorëve të prodhimit dhe në veçanti të punës;
3. Në stabilitetin e tregut, duke garantuar qëndrueshmëri në prodhimin bujqësor;
4. Në cilësinë dhe sigurinë ushqimore, duke garantuar që zinxhiri ushqimor të ketë një cilësi të qëndrueshme dhe të mos shkaktojë pasoja të dëmshme në shëndetin e njerëzve;
5. Në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, duke garantuar që bujqësia të ruajë burimet natyrore;

6. Në uljen e varfërisë, në zvogëlimin e pabarazive ndërmjet niveleve të zhvillimit të rajoneve të ndryshme, si edhe të prapambetjes së zonave rurale, më pak të favorizuara, duke zhvilluar veprimtari alternative dhe plotësuese, që gjenerojnë punësim, me synim ngadalësimin e largimit të popullsisë nga fshatrat, si dhe duke fuqizuar biznesin e vogël dhe të mesëm.
7. Midis faktorëve që duhet të përmirësohen për të rritur nivelin e qëndrueshmërisë ekonomike të fermave janë:
 - i. njohuri më të avancuara bujqësore;
 - ii. aksesin në teknologji/pajisje/makineri të reja dhe rritja e aksesit në kreditim (si për prodhimin dhe për investimet);
 - iii. kapaciteti i magazinimit në nivel ferme;
 - iv. strukturat e bashkëpunimit etj.

Objektivat e Planit Lokal të Zhvillimit Bujqësor 2025-2027

| Objektivi | Masa/Veprimi/ Ndërhyrja | Treguesi | Buxheti | Afati | Shënime |
|-------------------------------------|--|--|--|-----------|---|
| 1. Qartësimi i së drejtës së pronës | 1.1 Kryerja e regjistrimit fillestar në zonat ku nuk ka kaluar si dhe i disa parcelave brenda zonave me regjistrim fillestar | Nr. i ngastrave të regjistruara sipas zonave kadastrale. | | 2025-2027 | Kërkesë bashkëpunimi ose marrëveshje me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës sipas kuadrit ligjor. |
| | 1.2 Përmirësim/përditësimi i parcelave të evidentuara me gabime hartografike (ku nuk përputhet fakti me hartën kadastrale) | Nr. i parcelave të përmirësuara dhe legjitimuara nga ASHK. | | | |
| 2. Investime në infrastrukturë | 2.1 Rehabilitimi i rrugëve bujqësore | Km rrugë të shtruara. | Buxheti i bashkisë Programi "Shërbimet bujqësore" | Çdo vit | |
| | 2.2 Krijimi i skemave alternative të ujitjes (puse) | Sipërfaqja (Ha) e shtuar me ujti | Buxheti i bashkisë, Fonde nga MBZHR, Donatorë | 2025-2027 | Kërkohet plan fizibiliteti, preventivim dhe projekt i detajuar. |
| | 2.3 Mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemit të ujitjes dhe kullimit. | Km kanale kullues dhe ujti të mirëmbajtur | Fondi specifik | Çdo vit | Bujqësia është veçarërisht e ekspozuar ndaj ndryshimeve klimatike. Zvogëlimi i reshjeve dhe rritja e temperaturave do të ndikojnë, si në sasinë ashtu |

Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor 2025-2027

| | | | | | |
|--|---|--|---------------------------|----------------|--|
| | | | | | <p>edhe në cilësinë e ujërave të ëmbla. Kjo do të ndikojë në produktivitetin bujqësor dhe sigurimin e ushqimit të vendit, si dhe në jetesën rurale. Pavarësisht se niveli i reshjeve do të ulet në përgjithësi, shirat priten të jenë më intensive— duke e bërë bujqësinë më të varur nga sistemet e ujitjes dhe kullimit.</p> |
| <p>3. Mbështetje financiare të drejtpërdrejta ose jo</p> | <p>3.1 Mbështetje me grante lokale duke parasysh barazinë gjinore dhe start-up për fermerët e rinj.</p> <p>3.2 Mostrimi i tokave (boniteti) për tu ardhur në ndihmë fermerëve për përcaktimin e cilësisë së tokës dhe elementëve ushqyes, ndikimi i tyre në rritjen e rendimentit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore.</p> | <p>Nr i aplikantëve të mbështetur.</p> | <p>Buxheti i bashkisë</p> | <p>Çdo vit</p> | <p>Të planifikohen projekt propozime për target grupe të ndryshme në ide dhe shpërndarje territoriale.</p> <p>Kryerja e analizave sipas VKM-së Nr. 59, datë 28.1.2005 “Për kryerjen e analizave të vlerave të treguesve të tokës bujqësore”. Efikasiteti më i lartë në përdorimin e plehrave dhe të PMB-ve do të kërkojë jo vetëm makineri, por edhe analiza, testim të tokës dhe trajnimet përkatëse.</p> |

Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor 2025-2027

| | | | | |
|---|--|--|---|---|
| | <p>3.3 Mbështetje financiare për kostot operacionale* ose shpenzime të tjera për GVV "Itea Patos"</p> | <p>Buxheti i bashkisë MBZHR Donatorë</p> | <p>2025-2027</p> | <p>* Ligj nr. 36/2022 "Për organizimin dhe funksionimin e grupeve vendore të veprimit".</p> |
| <p>4.1 Nxitja e bashkëpunimit të fermerëve pasi kanë më tepër mundësi përfitimi nga skemat kombëtare.</p> | <p>Nr. i aplikimeve si grup fermerësh.</p> | <p>Çdo vit</p> | <p>Specialistët e Drejtorisë së Zhvillimit Bujqësor do të realizojnë takime informuese me fermerët para se të bëhen thirrjet për aplikime në skemat mbështetëse.</p> | |
| <p>4.2 Asistencë fermerëve për aplikime në skemat kombëtare dhe jo vetëm.</p> | <p>Nr. i fermerëve të asistuar.</p> | <p>Çdo vit</p> | | |
| <p>4. Mbështetje për zhvillimin lokal gjithëpërfshirës.</p> | <p>4.3 Krijimi i kadastrës së ullirit. Regjistrimi i njësive në një zonë kadastrale projekt pilot.</p> | <p>2025-2027</p> | <p>Është domosdoshmëri dhe përbën një mjet të rëndësishëm në mbështetje të hartimit të politikave të drejta për zhvillimin e sektorit të ullirit dhe vajit të ullirit. Gjithashtu, regjistri i ullirit do të shërbejë për orientimin e drejtë të fermerëve, tregtarëve dhe përpunuesve në gjithë zinxhirin e prodhimit, të tregtimit dhe krijimit të vlerave.</p> | |

Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor 2025-2027

| | Sasia e mbetjeve bujqësore që largohen nga fermerët. | Donatorë | 2025-2027 | |
|--|--|-----------------------------------|-----------|--|
| 5.1 Mundësia e ngritjes së një pike kompostimi për mbetjet e gjelbra. | Sipërfaqja e djegur. | | Çdo vit | Djegia e kashtës në ara e varfëron lëndën organike të tokës së punueshme dhe, përveç kësaj, nga zjarret rrezikohen pyjet, drurët frutorë dhe objekte të tjera publike dhe private. |
| 5.2 Nxitja e fermerëve për zbatimin rigoroz të legjislacionit mbi masat e parandalimit të përhapjes së zjarrit në tokë bujqësore. | Ulja e shpenzimit për energji elektrike në këto objekte | Bashkia MBZHR Donatorë | 2025-2027 | |
| 5.3 Përdorimi i energjisë së rinovueshme për furnizimin me energji të stacioneve të pompimit të ujit për ujti. Nxitja e përdorimit të paneleve diellor në objektet bujqësore dhe blegtorale. | | | | |
| 6. Sigurimi i të ardhurave të qëndrueshme për fermerët dhe rezistenca ndaj | 6.1 Ngritja e një pike grumbullimi dhe magazinimi frigoriferik në territorin e bashkisë Patos. | Persona fizik/juridik MBZHR/IPARD | 2025-2027 | |

Plani Lokal i Zhvillimit Bujqësor 2025-2027

| | | | | | |
|----------------------|--|--|-----------------------------------|-----------|---|
| presioneve të tregut | 6.2 Ndërtimi i një tregu bujqësor dhe blegtoral pasi marketingu i drejtpërdrejtë dhe zinxhirët e shkurtër të furnizimit duhet të përdoren si mjete për t'u rezistuar presioneve të tregut. | | Bashkia+ MBZHR Donatorë | 2025-2027 | Nga këndvështrimi i kërkesës së konsumatorit për kërkesat për përmirësimin e ushqimit dhe shëndetit, prodhimi i ushqimit të sigurt, me vlera ushqyese dhe të qëndrueshëm, reduktimi i mbetjeve ushqimore dhe mirëqenia e përmirësuar e kafshëve janë të nevojshme për të zbatuar standardet dhe objektivat e përcaktuar kombëtarë të bujqësisë, si edhe në Strategjinë e BE-së nga ferma në tavolinë. |
| | 6.3 Nxirja e fermerëve dhe agropërpunuesve për investime në mbështetje të përmirësimit të produktivitetit në punë, si p.sh. në mekanizim dhe në pajisje të reja. | | Persona fizik/juridik MBZHR/IPARD | 2025-2027 | |